

REPUBLIKA E KOSOVË / ÇS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VIADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org.	Nr. Prot:
Org. Jedinica	Broj Prot:
Org. Unit	Prot. No.:
Nr. i faqeve	Data:
Br. stranica	Datum:
No. pages	Date:
Prishtinë / a	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 23 korrik 2015

Ref. Nr: 214/01B

Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), dhe dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, nr. 1, 18 prill 2011), merr:

**V E N D I M**

1. **PLOTËSOHET** Udhëzimi Administrativ nr. 06/2015 (dt. 10.07.2015) për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, si vijon:

1.1. Neni 13 (*Dispozitat kalimtare*) plotësohet me paragrafin 4, si vijon:

4. Deri në vitin shkollor 2017/18 pasi të jenë përgatitur kuadrot e diplomuar në Fakultetin e Edukimit sipas Vendimit nr. 191/01B dt. 16.07.2012, në Shkollat e Mesme të Larta, klasat 10-12, përparësi për punësim kanë kuadrot me përgatitje në njësitë akademike në programet e akredituara arsimore në FSHMN, Fakultetin Filozofik dhe Fakultetin Filologjik.

1.2. Neni 6 (*Shkolla e Mesme e Lartë*) plotësohen paragrafet 1.1, 9.1, 10.1, 11.1, 12.1, 13.1, 14.1, 15.1, 22.1, si vijon:

1.1 Fakulteti i Edukimit - Programi Master i Mësimdhënies në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe;

9.1. Fakulteti i Edukimit - Programi Master i Mësimdhënies në Matematikë;

10.1. Fakulteti i Edukimit - Programi Master i Mësimdhënies në Biologji-Kimi ose Biologji;

11.1. Fakulteti i Edukimit - Programi Master i Mësimdhënies në Fizikë-Kimi ose Fizikë;

12.1. Fakulteti i Edukimit - Programi Master i Mësimdhënies në Biologji-Kimi ose Kimi;

13.1. Fakulteti i Edukimit - Programi Master i Mësimdhënies në Gjeografisë ose Gjeografi-Edukatë Qytetare.

14.1. Fakulteti i Edukimit - Programi Master i Mësimdhënies në Histori-Edukatë Qytetare ose Gjeografi-Edukatë Qytetare.

15.1. Fakulteti i Edukimit - Programi Master i Mësimdhënies së Historisë ose Histori-Edukatë qytetare;

22.1. Fakulteti i Edukimit - Programi Master i Mësimdhënies në Teknologji dhe TIK.

2. Obligohet Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar që brenda 2 (dy) ditëve të punës t'iu dërgojë këtë Vendimin të gjitha DKA-ve.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Sekretari i Përgjithshëm i MASHT, Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar dhe Departamenti Ligjor.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Iu dërgohet:

- Të gjitha DKA-ve
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar;
- Departamenti Ligjor;
- Arkivit të MASHT.